

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7078
E shtunë, 23 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Në prag të Krishtlindjeve,
Çekia në zi FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA FOLUR TË PREMTEN RRETH NORMALIZIMIT
TË MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SERBI DREJT VITIT 2024 FAQE 4-5

KURTI PROPOZON QË AI TA SHKRUAJË NJË DRAFT-STATUT PËR ASOCIACIONIN, OPOZITA I REAGON



Kryeministri Albin Kurti ka thënë të premtën se marrëveshja bazë, me aneksin e zbatimit për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, do të mund të nënshkruhet në Samitin e Këshillit Evropian që

mbahet me 21 dhe 22 mars 2024. Kurti, duke iu referuar deklarimit të fundit të emisarit evropian Miroslav Lajçak, se draft-statuti qenka veçse çështje e brendshme e Kosovës, ai thotë se në vitin e ardhshëm mund ta shkruajë një draft modern

evropian në konsultim me ministrat e vet Nenad Rashiç dhe Elbert Krasniqi. Ndaj kësaj deklarate kanë reaguar përfaqësuesit e opozitës, duke theksuar se kryeministri është shumë i vonshëm dhe askush nuk po e merr seriozisht

BULLGARIA PËRKRAH KOSOVËN PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS F. 3



KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE E FSK-SË KRYEN TRAJNIMIN "SIMBOLI I UJKUT 2023" F. 6



LDK-ja DËRGON NË KUSHTETUESE LIGJIN PËR FONDIN SOVRAN F. 8

EDHE HAJVALIA PO BËHET ME RRJET NËNTOKËSOR TË RI F. 8

SPORT



SFIDAT E SUPERLIGËS FILLOJNË ME NJË MINUTË HESHTJE PËR ILLMEN BAJRËN F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja miraton ndihmë prej 118 milionë eurosh për Autoritetin Palestinez

BRUKSEL, 22 DHJETOR - Komisioni Evropian të premtën ka njoftuar se ka miratuar një pako ndihmash prej 118 milionë eurosh për ta mbështetur Autoritetin Palestinez. KE-ja ka thënë se ndihma do të ndihmojë për t'i paguar pagat dhe pensionet e shërbyesve civilë në Bregun Perëndimor, ndihmat sociale për familjet në nevojë dhe mjekimin e pacientëve të dërguar në spitalet e Jerusalemit Lindor, raporton "Reuters".

Bashkimi Evropian është, po ashtu, i gatshëm të vazhdojë ta ndihmojë Autoritetin Palestinez në planin afatgjatë, ka thënë kryetarja e KE-së, Ursula von der Leyen. "Ne po shqyrtojmë një pako më të gjerë afatmesme për vitin e ardhshëm, për të kontribuar për stabilitetin ekonomik dhe politik të Gazës dhe të Bregut Perëndimor, sapo kushtet në terren të lejojnë këtë, si pjesë e përpjekjeve më të mëdha ndërkombëtare për një zgjidhje me dy shtete", ka deklaruar von

der Leyen nëpërmjet një komunikate.

Për vitin 2024, BE-ja, po ashtu, ka ndarë 125 milionë euro si ndihmë humanitare për njerëzit në Rripin e rrethuar të Gazës, ku kryediplomati evropian, Josep Borrell, ka thënë se mungesa e ushqimit ka arritur në nivele të paprecedente. "Ky është një zhvillim serioz dhe duhet të jetë alarm për mbarë botën, që të veprojmë tani, për të parandaluar një katastrofë vdekjeprurëse njerëzore", është shprehur Borrelli. "Ndihmat duhet të mbërrijnë tek ata që kanë nevojë, sido që të jetë e mundur, përfshirë përmes korridoreve humanitarë dhe pauzave për nevoja humanitare", ka deklaruar ai.

Në Gazë lufta më e përgjakshme nisi kur grupi radikal palestinez Hamas, i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-ja, e sulmoi Izraelin më 7 tetor, duke i vrarë rreth 1 200 njerëz, kryesisht civilë,



dhe duke i rrëmbyer rreth 250 të tjerë. Si përgjigje, Izraeli i nisi menjëherë bombardimet e

pareshura dhe pastaj pushtimin tokësor të enklavës palestineze, duke e rrënuar shumicën e veriut

të Gazës, si dhe duke i vrarë gati 20 000 palestinezë, sipas Ministrisë palestineze të Shëndetësisë.

Holanda do t'ia japë Ukrainës 18 avionë luftarakë F-16



Holanda do t'ia dërgojë Ukrainës 18 avionë luftarakë F-16 për t'i ndihmuar në betejën kundër pushtimit rus, ka njoftuar qeveria holandeze të premtën. "Sot e kam informuar presidentin [e Ukrainës, Volodymyr] Zelensky për vendimin e qeverisë sonë për t'i përgatitur 18 avionët e parë luftarakë F-16 për dërgim në Ukrainë", ka thënë ushtruesi i detyrës së kryeministrit, Mark Rutte, nëpërmjet një shkrimi në platformën sociale "X". "Dërgimi i F-16-shave është një ndër elementet më të rëndësishme të marrëveshjeve të arritura për mbështetje ushtarake për

Ukrainën", është shprehur ai. Dërgimi i avionëve luftarakë ende varet nga aprovimi për eksportim nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës dhe nga përmbushja e kriterëve për stafin dhe infrastrukturën në Ukrainë, ka shtuar Rutte, pa përmendur afate për këto vendime, raporton "Reuters".

Por, njoftimi i ndihmës ka bërë të mundshëm rezervimin e fondeve dhe njerëzve për përgatitjen e avionëve për dërgim, ka thënë qeveria holandeze. "Kam folur me Mark Rutten për ta falënderuar qeverinë holandeze për vendimin e saj për ta filluar përgatitjen e 18

avionëve të parë F-16 për dërgim në Ukrainë", ka thënë presidenti ukrainas Zelensky në "X".

Holanda ka dërguar F-16-shin e parë, prodhim amerikan, në një qendër të re trajnimit për pilotët dhe stafin ukrainas, në Rumani, muajin e kaluar.

Danimarka, Norvegjia dhe Belgjika, po ashtu, kanë njoftuar se do t'i japin Ukrainës avionë F-16, pasi qeveria e Shteteve të Bashkuara ka aprovuar dërgimin e tyre që Kievi të mbrohet kundër Moskës, sapo të jetë përfunduar trajnimi i pilotëve.

Lufta e plotë e Rosisë në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Në prag të Krishtlindjeve, Çekia në zi

PRAGË, 22 DHJETOR - Të shtënata masive shkundën pasditën e 21 dhjetorit njërin nga vendet më të sigurta në botë. Me trembëdhjetë njerëz të vrarë dhe dhjetëra të tjerë të plagosur, Praga e Çekisë u bë kryelajm. "Kemi menduar gjithmonë se kjo është një gjë që nuk na shqetëson neve", tha kryetari i kryeqytetit me 1.3 milion banorë, Bohuslav Svoboda. "Tani duket se, për fat të keq, edhe bota jonë po ndryshon", tha ai. Fakulteti i Arteve i Universitetit të Karlit, ku sulmuesi qëlloi me breshëri plumbash, gjendet në

zemër të Pragës historike - vetëm pak minuta në këmbë nga sheshi i Qytetit të Vjetër në njërin anë dhe nga Ura ikonë e Karlit në anën tjetër.

Zona është një atraksion i madh turistik, me mijëra vizitorë që në këtë kohë shijojnë tregjet e njohura të Krishtlindjeve.

Të dyshuarin për vrasje në hapësirat e universitetit, policia çeke e identifikoi si 24 vjeç, vetë student në Fakultetin e Arteve, dhe tha se ai u "eliminua". Sipas shefit të policisë, Martin Vondrashek, sulmuesi kishte leje armësh dhe posedonte disa të tilla.



Bullgaria përkrah Kosovën për anëtarësim në Këshillin e Evropës

Presidenti i Bullgarisë, Rumen Radev, gjatë vizitës në Kosovë, ka theksuar se Bullgaria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën për anëtarësim në Këshillin e Evropës. “Bullgaria është një prej motorëve për integrimin e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ne nuk mund ta lejojmë veten ta lëmë Kosovën në plan të dytë, aq më tepër në fushën e sigurisë”, ka thënë presidenti bullgar gjatë konferencës për medie me presidenten Vjosa Osmani

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Presidenti i Bullgarisë, Rumen Radev, ka vizituar të premtën Kosovën. Ai është takuar me presidenten Vjosa Osmani dhe pas takimit kanë pasur një paraqitje për medie. Osmani ka thënë se ngurrimi për ta pranuar vendin e saj në aleancën ushtarake NATO dhe në Bashkim Evropian (BE), lë të hapur mundësinë për destabilizimin “jo vetëm të Kosovës, por të rajonit dhe më gjerë”.

Duke folur në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin e Bullgarisë, Rumen Radev, në Prishtinë, Osmani ka thënë se Kosova llogaritet në mbështetjen bullgare për anëtarësim në bllok. “Udhëheqja e guximshme dhe veprimet vendimtare të aleatëve tanë në

familjen euroatlantike për ta përsheptuar pranimin e bazuar në meritat e vendeve demokratike të rajonit në BE dhe NATO, sepse çdo hezitim do të krijonte një boshllëk që aktorët keqdashës ta destabilizojnë jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin e përtej”, është shprehur Osmani.

Kosova aplikoi për anëtarësim në BE vitin e kaluar, por u qortua nga Komisioni Evropian në raportin e saj vjetor në nëntor për “përparim të kufizuar” dhe për moszbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun me Serbinë.

Presidenti bullgar ka thënë se derisa vendi i tij e mbështet Kosovën dhe gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor për anëtarësim në bllok, kërkon që Kosova dhe Serbia të pajtohen për normalizimin e marrëdhënieve. “Bullgaria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën për anëtarësimin e saj sa më parë në



Këshillin e Evropës. Bullgaria është një prej motorëve për integrimin e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ne nuk mund ta lejojmë veten ta lëmë Kosovën në plan të dytë, aq më tepër në fushën e sigurisë”, ka thënë Radev. Ai shtoi se arritja e marrëveshjes për normalizimin e

marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës “është me rëndësi për sigurinë, stabilitetin dhe mirëqenien e rajonit tonë”.

Gjendja në veriun e Kosovës, i banuar me shumicë serbe, vazhdon të jetë i tensionuar prej fillimit të këtij viti, kur serbët lokalë i kundërshtuan kryetarët shqiptarë në katër komunat me shumicë serbe, të cilët dolën nga zgjedhjet e bojkotuar nga serbët në prill. Më 24 shtator gjendja u përshkallëzuan pasi Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur i serbëve në fshatin Banjskë të Zveçanit, ku mbeti i vrarë polici Afrim Bunjaku. Gjatë përleshjeve që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova ka fajësuar Serbinë për sulmin, por Beogradi ka mohuar përfshirjen në të.

Radev tha se Bullgaria vazhdon të ngulë këmbë për dialogun si mënyrë e vetme për zgjidhjen e problemeve dhe paralelisht zbatimin e të gjitha marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Mendojmë se kjo është rruga e vetme. Ne përjashtojmë provokimet e armatosura dhe dhunën. Ne ngulim këmbë që BE-ja ta ketë një rol aktiv për dialogun intensiv dhe gjetjen e zgjidhjeve”,

shtoi ai.

Osmani tha se ka prirje nga disa vende për t'i keqpërdorur masat që Bashkimi Evropian i vendosi në fillim të këtij viti ndaj Kosovës për ta “kushtëzuar atë për çështje plotësisht të tjera”.

Më herët gjatë vitit, BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës, ku banorët lokalë kundërshtojnë kryetarët e rinj shqiptarë të komunave. “Sa i përket masave, ato është dashur të hiqen moti, në fakt nuk është dashur të vendosen kurrë, përkundër mospajtimeve që kanë ekzistuar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe partnerëve në BE sa i përket 26 majit”, tha Osmani.

Ajo nguli këmbë se Kosova i ka plotësuar kushtet për heqjen e masave, duke thënë se “ato që janë kërkuar nga Kosova për ato që e quanin deeskalim kanë ndodhur”. “Ka tendencë nga disa që tani masat keqpërdoren si mënyrë për ta kushtëzuar Kosovën për çështje komplet të ndryshme nga arsyeja për të cilën ato janë vendosur në fillim. Një qasje të tillë e kam kundërshtuar në samitin BE-Balkan Perëndimor më 13 dhjetor”, shtoi ajo, duke besuar se një kushtëzim i tillë “do të ketë vetëm ndikim negativ”.



Komanda e Forcave Tokësore e FSK-së kryen trajnimin “Simboli i Ujkut 2023”

Prishtinë, 22 dhjetor - Në kuadër të planifikimeve për ngritjen dhe avancimin profesional të pjesëtarëve të FSK-së, Komanda e Forcave Tokësore (KFT) ka realizuar trajnimin “Simboli i Ujkut 2023”.

Në ceremoninë e organizuar në Kazerminë “Ushtarët e NATO-s” në Istog, shefi i shtabit të KFT-së, kolonel Valdet Berisha, ka theksuar se ky trajnim e rritë nivelin e

aftësive profesionale taktike dhe të udhëheqjes së pjesëtarëve për të manovruar e vepruar nën stres dhe situata të ndërlikuara në fushë-betejë. Ai ka thënë se nga raportimet e instruktorëve, kursantët kanë dëshmuar përkushtim dhe angazhim serioz. “Disiplina dhe gatishmëria e pjesëtarëve në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me saktësi dhe në nivel të lartë profesional është ajo që atë dhe stafin e

Shtabit të KFT-së e bënë më së shumti krenar”, është shprehur Berisha.

Trajnimi “Simboli i Ujkut 2023” ishte gjenerata e nëntë me radhë e planifikuar dhe realizuar nga KFT, ku pjesëtarët u sfiduan në shumë disiplina, ku treguan performancë dhe leadership gjatë periudhës së trajnimit. Trajnimi u realizua në terren malor dhe urban dhe me kushte të vështira të motit.





KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA FOLUR TË PREMTEN RRETH NORMALIZIMIT TË MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SERBI DREJT VITIT 2024

Kurti propozon që ai ta shkruajë një draft-statut për Asociacionin, opozita i reagon

Kryeministri Albin Kurti ka thënë të premtën se marrëveshja bazë, me aneksin e zbatimit për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, do të mund të nënshkruhet në Samitin e Këshillit Evropian që mbahet me 21 dhe 22 mars 2024. Kurti, duke iu referuar deklaratës së fundit të emisarit evropian Miroslav Lajçak, se draft-statuti qenka veçse çështje e brendshme e Kosovës, ai thotë se në vitin e ardhshëm mund ta shkruajë një draft modern evropian në konsultim me ministrat e vet Nenad Rashiç dhe Elbert Krasniqi. Ndaj kësaj deklarate kanë reaguar përfaqësuesit e opozitës, duke theksuar se kryeministri është shumë i vonshëm dhe askush nuk po e merr seriozisht

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në "Facebook" ka shkruar lidhur me normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë në vitin 2024. Ai tha se për qeverinë e tij prioritet mbeten siguria e Kosovës, integriteti territorial dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së të gjithë qytetarëve pa dallim.

Në këtë drejtim Kurti ka paraqitur 7 pika: "1) Prioritet absolut për Qeverinë e Republikës së Kosovës është siguria për Kosovën, integriteti

territorial i shtetit dhe jeta e mirëqenia e qytetarëve pa dallim. 2) Konkluzionet e hetimeve për sulmin terrorist e kriminal të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit, kur u vra rreshteri Afrim Bunjaku, duhet të bëhen publike menjëherë. Millan Radojçiq dhe pjesëtarët e grupit të tij paramilitar duhet t'u dorëzohen autoriteteve të Kosovës", ka shkruar Kurti.

Ndërkaq në pikën 3 Kurti shpreson se Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja do t'i vendosin sanksione Serbisë, posaçërisht presidentit të saj Aleksandër Vuçiq, për sjelljet dhe veprimet armiqësore e agresore ndaj

Kosovës, për eskalimin në veri të vendit tonë dhe për heqje dorë nga Marrëveshja Bazë (nëpërmjet letrës së kryeminstres së Serbisë, Ana Bërnabiq, të 14 dhjetorit).

Kurti duke iu referuar deklaratës së fundit të emisarit evropian Miroslav Lajçak, se meqë drafti statuti qenka veçse çështje e brendshme e Kosovës, ai thotë se në vitin e ardhshëm mund ta shkruajë një draft modern evropian në konsultim me ministrat e vet Nenad Rashiç dhe Elbert Krasniqi. "4) Kërkesa ime është që Kosovës t'i hiqen masat ndëshkuese të BE-së dhe ShBA-së, dhe vendit tonë t'i

jepet statusi i vendit kandidat për BE e Partneriteti për Paqe me NATO. Pikërisht kështu partnerët tanë perëndimorë do t'i kërkonin fuqishëm Serbisë ta zbatonte obligimin e njohjes de facto të Kosovës. 5) Draft statutin e Asociacionit mua më thuhej se duhet ta pranojë edhe Serbia (andaj qysh në takimin e Ohrit kam ofruar që ta shkruaj atë mbi tri parime, ofertë kjo që u refuzua nga Vuçiqi). Sipas deklaratës së fundit të emisarit evropian Miroslav Lajçak, meqë drafti statuti na qenka veçse çështje e brendshme e Kosovës, në vitin e ardhshëm unë mund ta shkruaj një draft modern evropian në konsultim me ministrat e mi Nenad Rashiç (Komunitete dhe Kthim) dhe Elbert Krasniqi (Administrimi i Pushtetit Lokal). 6) Marrëveshja Bazike (me Aneksin e Zbatimit) për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të mund të nënshkruhet në Samitin e Këshillit Evropian që mbahet në datat 21 e 22 mars 2024", ka shkruar Kurti.

Në pikën 7 kryeministri beson se Brukseli dhe emisari evropian Lajçak do të merren shumë më tepër me presidentin e Serbisë, Vuçiq, që i vodhi zgjedhjet në Serbi me ndihmën e Dodikut, Mandiqit e Radojçiqit (sidomos në Beograd) dhe që u tërhoq nga Marrëveshja Bazë e 27 shkurtit 2023 (përmes letrës së kryeminstres Ana Bërnabiq), në vend se "të na bëjnë presion publik me opsione që e shndërrojnë Kosovën demokratike e pro-evropiane në temë problematike".

Abdixhiku, Kurtit: Shumë vonë për të propozuar tani draft për Asociacionin, ke pranuar autonomi

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, pas deklaratës së kryeministrit, ka theksuar se ka plot dy vjet që partia që drejton dhe të gjithë miqtë më të afërt të Kosovës i kërkojnë kryeministrit

Kurti dhe Nagavci ndajnë shpërblime për nxënësit fitues të garave vendore dhe ndërkombëtare

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Nxënësit fitues të garave në nivel vendi dhe atyre në nivel ndërkombëtar u bashkuan të premten në një ceremoni kremtimi nën praninë e kryeministrit Albin Kurtit dhe ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, të cilët u dhanë fituesve mirënjohje dhe shpërblime simbolike.

Duke vlerësuar të arriturat e të rinjve tanë, kryeministri Kurti tha se këtyre fitoreve u shtohet edhe më shumë vlera, duke qenë nga fushat e matematikës dhe fizikës. “Këto rezultate nga

gara me bashkëmohatarët tuaj nga vende të ndryshme të botës janë dëshmi për potencialin që ju e keni. Andaj ushqejeni këtë potencial vazhdimisht e realizojeni plotësisht talentin, imagjinatën dhe kreativitetin tuaj”, u shpreh ai.

Që nga marrja e mandatit, e pandalshme mbetet mbështetja dhe angazhimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për nxënësit dhe studentët. Ndër hapat e ndërmarrë në këtë fushë, kryeministri veçoi arsimin dual në 12 profile, 21 shkolla e 14 komuna; arsimin falas në nivelin e lartë publik; si

dhe ndarjen e bursave për notë mesatare të lartë, bursave të tjera për studime brenda dhe jashtë vendit, bursave për studentët e komuniteteve dhe ata me aftësi të kufizuara, si dhe bursave për vajzat në fushën STEM. “Në vitin 2023, në këtë vit në të cilin ngadalë po e përmbyllim në këto ditët e fundit të vitit, ndamë 1 647 bursa Bachelor dhe Master për studentët me notë të lartë mesatare; 1 882 bursa për vajzat që studiojnë në fushat STEM; 55 bursa për studentët e komuniteteve; 28 bursa për studentët me aftësi të kufizuara;

43 bursa për studentët e doktoratës që studiojnë jashtë në 500 universitetet më të mira; dhe 100 bursa për profilet deficitare”, ka thënë kryeministri.

Para nxënësve dhe prindërve ai përmendi se hapat e tjerë për krijimin e kushteve optimale për mësim janë edhe miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, pra për edukim të obligueshëm e cilësor nga mosha 0-6 vjeç, dhe Projektligji për Tekste Shkollore ku përcaktohen normat dhe standardet për tekste të sakta dhe kompetente për nivelin

parauniversitar.

Në anën tjetër, qeveria javën e kaluar miratoi buxhetin më të madh të arsimit që ka pasur Kosova ndonjëherë, me rreth 409 milionë euro, fakt që dëshmon prioritetin dhe përkushtimin e pakursyer për nxënësit në çdo fazë të jetës parashkollore, shkollore dhe universitare.

Ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve dhe shpërblimeve simbolike për fituesit e garave në nivel vendi dhe atë ndërkombëtar u organizua nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.



Kurti që të hartojë draftin e statutit të Asociacionit si dokument i brendshëm i Kosovës. “Ka dy vjet që ‘kryeministri i shtetit të përkohshëm’, i ulur në tavolinë dialoguese me tre mosnjohjes të tjerë shteti, që ka refuzuar të bëjë një gjë të tillë. Në seancën e 3 nëntorit, e kuptuam arsyen. Na tha, ‘nuk kam dashur të shkruaj një dokument të tillë, meqë kam qenë i bindur se ndërmjetësuesi më pas do të sillte një mes të dokumentit të Kosovës dhe atij të Serbisë’. Por dokumenti i ndërmjetësuesit erdhi. Jo si mes, por dhe më rëndë, erdhi si autonomi!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.

Ai ka thënë se dy muaj më pas, tek pasi ka pranuar autonominë e serbëve në Kosovë, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, i ulur në karrigen e “kryeministrit të shtetit të përkohshëm”, del me propozim që tani Kosova ta shkruajë statutin e Asociacionit vetë. “Se qenka çështje e

brendshme e jona. E paska kuptuar nga ndërmjetësuesi. Dy vjet pas. Vonë. Shumë vonë. E dëmshme kjo vonesë. E kushtueshme kjo vonesë. I thonë sot autonomi! Autonomi e pranuar nga ‘kryeministri i shtetit të përkohshëm’ dhe presidenti i Serbisë. Dhe jo vetëm kaq. Ka plot dy muaj që si narracion kryesor të tij, na thotë se ka qenë i gatshëm të nënshkruaj Draft Statutin e Asociacionin me Presidentin e Serbisë. Madje që atë ditë. Merreni me mend, një dokument të brendshëm të Kosovës, ta nënshkruaj jo një President Kosove por një president, hiç më pak se ai i Serbisë. Ka plot dy muaj që ngrisim në pah këtë çmenduri; dhe tek sot, dy muaj më pas, s’kërkon këtë nënshkrim. Nënshkrimi i draft statutit me Serbinë s’është më kërkesë. Çfarë ndodhi ‘kryeministër i përkohshëm’? E kuptove - më në fund - këtë çmenduri? A e

kuptoni se sa pak di? A e kuptoni se sa e dëmshme është kjo vonesë e tij. Paqëndrueshmëria e tij është thelbi i pasigurisë! Padiuria e tij është çmimi që paguajmë sot dhe nesër të gjithë”, ka shkruar Abdixhiku.

Çitaku: Kryeministër, askush nuk po të merr seriozisht

Edhe nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka reaguar ndaj deklaratës së kryeministrit Albin Kurti. “Kryeministri Kurti i paska postuar edhe nja 7 pika të reja: janë joserioze! Në fakt, ai vet është joserioz”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”. Ajo ka paraqitur një kronologji rreth kësaj.

“Një palaço jo-qesharak. Qe një kronologji: 1. Për 6-7 vjet, Albin Kurti ka përdorur dhunë kundër çfarëdo marrëveshje të ndihmuar nga aleatët, duke mos

kursyer asgjë dhe askënd: Është derdhur edhe gjak nëpër rrugë, janë hedhur bomba, gaz lotsjellës dhe është thirrur në luftë vëllavrasëse. 2. Pas ardhjes në pushtet, tash Albin Kurti thotë që nuk e ka prioritet dialogun, dhe zbulon formula të ndryshme, përfshi ‘pesë kushte’, ‘tre principe’, ‘gjashtë pika’ dhe zbulime të tjera të cilat janë harruar ca ditë më pas, ngase askush s’i ka marrë seriozisht - madje as ai. 3. Për dy vjet aleatët perëndimorë dhe qytetarët e presin kryeministrin Kurti të marrë vendim dhe t’i jap drejtim dialogut, i cili ka pasur synim njohjen e ndërsjellë. E vonon procesin dhe krijon drama të përditshme, duke reduktuar dialogun në çështje teknike. 4. Pasi që përlehet me Lajçak, Borrell dhe gjysmën tjetër të botës, e si pasojë Kosovës i sjell edhe sanksione ndërkombëtare të cilat ende janë në fuqi, në një aksham pazar, pa kurrfarë koordinimi dhe me një

paturpësi të pashoq, e pranon një statut të draftuar nga vetë Lajçak, të cilin e quante pro-serb, për autonomi pa njohje të ndërsjellë. 5. Tash, pasi që i ka parë rezultatet shkatërruese të politikës së tij të jashtme dhe udhëheqjes amatoreske të dialogut, kryeministri qohet dhe propozon 7 pika dhe kthehet pikërisht aty ku kemi qenë para tri vitesh, duke thënë se vetë do ta draftojë statutin”, ka shkruar Çitaku, duke iu drejtuar Kurtit se është i vonshëm. “Kryeministër, je edhe vonë edhe i vonshëm. Askush nuk po të merr seriozisht. Të gjithë, e më së shumti aleatët ndërkombëtarë, i injorojnë fjalimet dhe pikat e tuaja të shumta që propozon tash e sa vjet. Kosova ende vuan nën sanksione bashkë me Rusinë dhe Bjellorusinë. Fokusohu, merr vendime, e mos u merr me fjalime dhe postime. Facebooku nuk është mjet adekuat për ‘face-saving’”, ka shkruar Çitaku.

Shpërndahen motokultivatorë për fermerët llapjanë

PODUJEVË, 22 DHJETOR - Drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, Vigan Salihu, bashkë me përfaqësuesen e Islamic Relief, Albulena Gashi, morën pjesë në procesin e shpërndarjes së motokultivatorëve për 73

fermerët përfitues nga projekti i marrëveshjes në mes të komunës së Podujevës me organizatën "Islamic Relief". Motokultivatorët e shpërndarë për fermerët përfitues janë: 50 motokultivatorë me frezë, ndërsa 23 motokultivatorë me

kosë.

Drejtori Salihu i uroi fermerët përfitues dhe e falënderoi organizatën për ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm për fermerët në komunën e Podujevës në projekte të ndryshme.



Sekuestrohen kamera të sigurisë në fshatrat e banuara me serbë në rajonin e Gjilanit

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Rreth 50 kamera të sigurisë, të cilat kishin qenë të vendosura në zona të banuara me shumicë serbe në rajonin e Gjilanit, janë konfiskuar nga Policia e Kosovës të premtën. Prokuroria e Gjilanit ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se konfiskimi është bërë nga Policia, me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Gjilan, dhe me urdhër të gjykatës kompetente në Gjilan. "Dyshohet se të njëjtat [kamera] janë përdorur për fotografime dhe incizime të paautorizuara", ka thënë Liridona Xheladini, zyrtare për komunikim në Prokurorinë e Gjilanit.

Prokuroria nuk ka treguar saktë se në cilat zona është bërë sekuestrimi, teksa ka thënë se bëhet fjalë për fshatra të banuara me shumicë serbe në rajonin e Gjilanit.

Përveç disa fshatrave në komunën e Gjilanit, që janë të banuara me serbë, në rajonin e Gjilanit përfshihen edhe dy komuna të tjera ku serbët përbëjnë shumicën - Ranilluku dhe Parteshi.



Në këto dy të fundit, "Radio Evropa e Lirë" në vitin 2022 pati raportuar se janë të vendosura dhjetëra kamera të sigurisë nëpër hapësira publike, të cilat

nuk dihen se nga kush kontrollohen.

Më 2022 "REL"-i ka raportuar se kamerat e sigurisë, që nuk dihet se kush i kontrollon, vëzhgojnë

edhe hapësirat publike në katër komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

Kamerat e tilla janë të vendosura në Mitrovicë të Veriut, Zvečan,

Leposaviq dhe Zubin Potok. Sipas ligjeve në fuqi, në Kosovë vëzhgimi i hapësirave publike me kamera mund të bëhet vetëm për nevoja të Policisë së Kosovës.

Policia në Mitrovicën e Jugut shton kontrollet për parandalimin e aksidenteve



Mitrovicë, 22 dhjetor - Policia në rajonin e Mitrovicës së Jugut, me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit-sensibilizimit, të shoferëve për parandalimin e aksidenteve dhe ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë kësaj jave me moton "Mos lejo që shpejtësia të të udhëheqë!", në të gjitha akset rrugore ka shtuar kontrollet me fokus respektimi i shpejtësisë, ku njëkohësisht për shoferët po shpërndahen fletushka me këshilla për respektimin e kufizimeve të shpejtësisë.

Përveç kontrolleve rutinë, kontrolleve me radarë, dhe masave të tjera ndëshkimore, nga data 1 deri më 20 dhjetor janë shqiptuar gjithsej 3 589 gjoba, nga këto vetëm për mosrespektim të shpejtësisë janë shqiptuar 1 719 gjoba. Policia u bënë thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trafikun rrugor, në veçanti shoferëve, me qëllim që të mos rrezikojnë veten dhe pjesëmarrësit e tjerë, t'u përmbahen rregullave të përcaktuara me ligjin për sigurinë në trafik.

Në Rahovec fillon aksioni për heqjen e deponive ilegale

Rahovec, 22 dhjetor - Në komunën e Rahovecit ka filluar aksioni për heqjen e deponive ilegale. Sipas njoftimit për medie, aksioni do të vazhdojë derisa të eliminohen të gjitha deponitë ilegale në territorin e komunës së Rahovecit, duke falënderuar

kompaninë Eae-Njaz për heqjen e dy deponive në mënyrë vullnetare. "Ambientet dhe hapësirat e pastruara dhe ato që do të pastrohen do të jenë të mbrojtura me ligj dhe do të ndëshkohet cilido qoftë që tani e tutje hedh mbeturina vend e pa vend. Në pjesët ku

janë duke u larguar deponitë ilegale do të shtohet inspektimi nga Drejtoria e Inspeksionit dhe do të pasojnë dënime të rënda për të gjithë ata që hedhin mbeturina në vende dhe hapësira të gjelbra", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



Octopus: Lajmet e rreme nga Serbia e Rusia synojnë ta dëmtojnë imazhin e Kosovës

Prishtinë, 22 dhjetor - Fushatat e vazhdueshme të lajmeve të rrejshme të bëra nga Rusia dhe Serbia kundër Kosovës kanë për qëllim dëmtimin e sovranitetit dhe imazhit të vendit. Përveç kësaj, ka për qëllim diskreditimin e personaliteteve të larta dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të tensionit ndëretnik. Kështu u tha të premten në konferencën "Propaganda mediatike serbe dhe ruse në Kosovë", e organizuar nga Instituti Octopus.

Drejtori i Institutit për Studimin e Kërcënimeve Hibride "Octopus", Agim Musliu, derisa foli për hulumtimin e vërë se si ndikon propaganda e medieve ruse dhe serbe në Kosovë, përmendi një lajm të rremë të publikuar nga mediet serbe "Kosovo Online". Ai tha se kjo medie ditën e sulmit terrorist të 24 shtatorit publikoi një artikull të rremë që ka të bëjë

me komunikimin e Policisë së Kosovës në radiolidhje, si neglizhencë e policisë ndaj një të burgosurit serb.

Lidhur me këtë, Musliu tha se "Kosovo Online" nuk ka asnjë fakt, pjesë të audiomaterialit apo diçka tjetër që e mbështet pretendimin e saj se në atë komunikim po neglizhohet një i plagosur serb.

Ndërkaq, hulumtuesi i lartë në Octopus, Taulant Elshani, tha se mediuni "Kosovo Online" është shndërruar në një epiqendër për luftë speciale dhe dezinformim kundër Kosovës, duke publikuar lajme të rreme, sipas tij, plotësisht në përputhje me vijën zyrtare të politikës në Beograd.

Përveç kësaj, Elshani foli edhe për lidhjen e medieve ruse "Sputnik Serbia" dhe "RT" me Serbinë, derisa tha se "Sputnik Serbia" është ueb lajmsh i sponsorizuar nga Kremli për propagandë të



lajmeve dhe narrativave në gjuhën serbe.

Ai shtoi se medie "Kosovo Online", "Sputnik Serbia" dhe "RT" janë në sinkronizim për të goditur me fushata të mirorganizuar pavarësinë e Kosovës, paqen

rajonale dhe se, sipas tij, synon shembjen e rendit dhe progresit që Perëndimi ka arritur në Ballkan.

Në hulumtimin e Octopus "Propaganda mediatike serbe dhe ruse në Kosovë" thuhet se

Rusia e përdor medien për ta sponsorizuar fuqinë e saj, për t'i arritur qëllimet e veta që kanë të bëjnë me glorifikimin, shtyrjen dhe influencën e elementeve destabilizuese të politikës së saj. /kp/

Maqedonci me homologun sloven: Sulmi i 24 shtatorit shqetësues, prapa tij qëndrojnë strukturat shtetërore të Serbisë

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të premten në takim ministrin e Mbrojtjes të Sllovenisë, Marjan Sarec, i cili ishte i shoqëruar nga ambasadorja e Sllovenisë në Kosovë, Minca Benedejcic, dhe pjesëtarë të tjerë të delegacionit të tij. Gjithashtu, në këtë takim morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, shefi i stafit të FSK-së, gjeneral brigade Ilir Qeriqi, drejtori i Politikave të Mbrojtjes, Faruk Geci, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euro-Atlantike, kolonel Sylejman Cakaj, këshilltarja e ministrit, Liridona Gashi dhe rreshter majori i FSK-së, Bedri Zuka.

Fillimisht, temë e këtij takimi ishte situata e sigurisë në vend dhe më gjerë, ku me këtë rast, ministri Maqedonci theksoi se sulmi i 24



shtatorit është shqetësues për faktin se prapa tij qëndrojnë strukturat shtetërore të Serbisë, andaj ai tha se duhet trajtuar me

shumë vëmendje si veprim që tregon hapur tendencën për destabilizimin e vendit, rrjedhimisht të Ballkanit

Perëndimor.

Krahas situatës së sigurisë, ministri Maqedonci e njoftoi homologun e tij sloven me të gjitha përparimet e

FSK-së gjerë më tani, për kapacitetet dhe vullnetin për ta thelluar bashkëpunimin me forcat slovene, përmes trajnimeve dhe misioneve të përbashkëta, si dhe aktiviteteve të tjera ushtarake që mund të zhvillohen përtej planit bilateral.

Gjithashtu, ministri Maqedonci shprehu qëndrimin e Kosovës sa i përket luftës në Ukrainë dhe synimin e qartë që kemi si shtet për anëtarësim në BE, A5 dhe në NATO. Me këtë rast, ai kërkoi nga homologu i tij mbështetjen e Sllovenisë në rrugëtimin e Kosovës për anëtarësim në organizatat euroatlantike.

Nga ana e tij, ministri Sarec garantoi mbështetjen e padiskutueshme të shtetit sloven për Kosovën dhe shprehu vullnetin e tij të bashkëpunimit të deritashëm që kanë dy vendet ta thellojnë edhe më tutje.

Babai dhe vëllai i Liridonës takojnë prokuroren: Mbesim me shpresë që rasti do të zgjidhet në mënyrë profesionale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Familja e së ndjerës Liridona Ademaj, e cila javë më parë është vvarë, ka njoftuar se pas kërkesës së tyre për takim urgjent me Prokurorinë për t'u njoftuar me hetimet që janë duke u zhvilluar në rastin e vajzës/motrës së tyre, ka bërë me dije se të premten kanë mbajtur një takim në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Leonard Ademaj, vëllai i Liridonës, në një postim në "Facebook", ka njoftuar për këtë takim, duke theksuar se janë informuar rreth rastit të vrasjes së motrës së tij, brenda kufijve që lejon ligji. "Sot

mbajtëm takim në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe u informuam rreth rastit të vrasjes së Liridonës sonë, brenda kufijve që lejon ligji. Ky takim na e lehtësoi dhimbjen dhe na ofroi një siguri edhe më të madhe që hetimet janë duke shkuar mirë. U pajtuam që tani e tutje do të kemi takime të rregullta informuese. Ne u shprehëm falënderimet hetuesve, prokurores së rastit dhe të gjithë prokuroreve që janë duke ndihmuar në zbardhjen e plotë të rastit. Ne besojmë në të gjitha institucionet e drejtësisë dhe mbesim me shpresë që rasti do të zgjidhet në mënyrë profesionale", ka thënë pas takimit Leonard Ademaj.



Mustafa: Investimet e sektorit privat po shënojnë rënie të vazhdueshme

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Koordinator i për Financa në kuadër të Kabinetit për Qeverisje të Mirë të PDK-së, Arben Mustafa, ka thënë se investimet private në Kosovë në tremujorin e tretë të këtij

viti shënuan rënie reale vjetore rreth 19.9 për qind. Mustafa në "Facebook" ka shkruar se pasqyra e investimeve të sektorit privat është pasqyra më reale e gjendjes së ekonomisë së

vendit. "Investimet e sektorit privat në Kosovë po shënojnë rënie të vazhdueshme përgjatë vitit 2023. Në tremujorin e tretë të këtij viti, investimet private shënuan një rënie reale vjetore prej

rreth 19.9 për qind (vlerësim i bazuar në të dhënat e ASK-së). Pasqyra e investimeve të sektorit privat është pasqyra më reale e gjendjes së ekonomisë së vendit", ka shkruar Mustafa.



Edhe Hajvalia po bëhet me rrjet nëntokësor komplet të ri

Prishtinë, 22 dhjetor- Rreth 8 mijë qytetarë të Hajvalisë me rrethinë do të përfitojnë nga investimi që po bën KEDS aty. E njohur si Dalja 6, ajo shërben si përcuese e tensionit të mesëm dhe në gjatësinë e saj 10 kilometërshë po bëhet komplet e re dhe me kapacitete të dyfishuara nga 10 kV në 20 kV. Aty do të vendosen edhe 9 transformatorë të rinj, nga të cilët tri do të jenë trafostacione komplete.

Tashmë, një pjesë e konsiderueshme e punëve janë kryer, përderisa ato vazhdojnë me intensitet të shtuar. Le t'ndihmim

Rrjeti i tensionit të mesëm do të jetë komplet nëntokësor nga nënstacioni Prishtina 7, afër Pallatit të Drejtësisë e deri te fundi i tij, duke i përfshirë edhe disa degëzime në Hajvali, të cilat aktualisht janë në shtylla me rrjet ajror.

Ky projekt parashihet të ketë impakt edhe në ekonominë e vendit, pasi përgjatë saj janë të alokuara një numër i konsiderueshëm biznesesh, të cilat do të marrin shërbime më kualitative, gjithashtu edhe më të sigurt.

Paralel me të është duke u




ndërtuar komplet e re edhe Dalja 5 që shkon në drejtim të Veternikut dhe në magjistralen drejt Ferizajt. Me kompletimin

e këtyre dy daljeve, po shkon drejt realizimit të plotë megaprojekti për Prishtinën që parasheh dyfishim të

kapaciteteve të tensionit të mesëm dhe futjen në tokë edhe të atyre daljeve që më parë ishin ajrore. Kjo

nënkupton që infrastruktura elektroenergjetike e Prishtinës po përgatitet për dekadat e ardhshme.

LDK-ja dërgon në Kushtetuese Ligjin për Fondin Sovran



Prishtinë, 22 dhjetor - Lidhja Demokratike e Kosovës të premten e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim Ligjin për Fondin Sovran, i cili javë më parë u miratua në Kuvendin e Kosovës. Ligjin për Fondin Sovran në Kushtetuese e dërguan deputeti i LDK-së, Besian Mustafa dhe anëtar i kryesisë, Berat Rukiqi. Paralajmërim për dërgimin e ligjit në fjalë në Kushtetuese dha edhe Partia Demokratike e Kosovës. 62 deputetë të Kuvendit të Kosovës votuan për këtë projektligj, pa asnjë votë kundër e asnjë abstenim.

Ligji për Fondin Sovran nga Qeveria e Kosovës u proklamua si projekt më i madh ekonomik në vend, projekt ky i cili, sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, vendos Kosovën në hartën e tregjeve botërore financiare. Megjithatë, partitë opozitare ligjin në fjalë e cilësuan të dëmshëm për konkurrencën, investimet private, ndërmarjet publike dhe buxhetin e shtetit.

Madje ata vlerësuan se Ligji për Fondin Sovran ka për bazë ideologjinë ekonomike që është e kundërta me liberalizimin ekonomik.

Protestojnë punëtorët e KEK-ut, kërkojnë rritje të pagave

Prishtinë, 22 dhjetor - Sindikata e Korporatës Energjetike të Kosovës ka protestuar të premten sërish

para zyrave të KEK-ut. Sipas sindikatës, kjo protestë vjen pas dështimit të marrëveshjes mbi ngritjen e pagave për


punëtorët. Sindikata e KEK-ut vlerëson se ngritja e pagave është e domosdoshme për mirëqenien dhe drejtësinë e

punëtorëve dhe paralajmëron hapa të tjerë sindikalë nëse nuk ka përmirësime konkrete në këtë drejtim.



Filmi “Maestro” – një rindërtim mjeshtëror dhe vetëm kaq

– Rreth filmit Maestro – për jetën e Leonard Bernstein – me skenar dhe regji nga Bradlye Cooper.
Të mërkurën, më 20 dhjetor 2023, filmi u shfaq në Netflix –



Nga: **Bilge EBIRI**,
kritik filmi / *Vulture*
Përktimi: *Telegrafi.com*

Carey Mulligan ka marrë rolin kryesor në filmin e Bradley Cooperit, për jetën e dirigjentit dhe kompozitorit Leonard Bernstein (që luhet nga Bradley Cooper). Dhe, e meriton. Në rolin e gruas së Bernsteinit – Felicia Montealegre – ajo duhet të përthith, të tërheq, të mbrojë dhe të rezistojë ndaj tërheqjes dhe refuzimit të burrit të saj brilant. Është performancë reaktive dhe Mulligani e luan në mënyrën që thyen zemrat e shumicës. Po, është statiste dhe “pjesë”, ashtu siç është Cooperi. Por, me të lidhemi në mënyrën siç nuk lidhemi me burrin e saj.

Në rolin e Bernsteinit, performanca e Cooperit e përfaqëson rindërtimin mjeshtëror, por mbetet veçse një rindërtim i tokëzuar dhe i ftohtë për t’u prekur. (Sa i përket spekulimeve për pjesën mbi hundë – nuk më duket aspak më ndryshe nga hunda jo aq e vogël e Cooperit, me përjashtim të skenave që e tregojnë atë si plak

ku puna e grimit dhe e maskës është mjaft e arrirë.) Ndihet se në mënyrë obsesive aktori e ka studiuar çdo paraqitje televizive, çdo centimetër të dokumentarëve për të rikrijuar diksionin dhe mënyrën e Bernsteinit, mënyrën e tij fodulle dhe të shpejtë të të folurit. Ndoshta ky është problemi. Duket sikur po e shohim një intervistë televizive me Bernsteinin; sikur ai e di se kamera është para tij. Pothuajse nuk ka momente të pambrojtura, intime. Ose, thënë më mirë, nuk ka momente të pambrojtura intime që nuk ndihen si momente të mbrojtura publike. Problemi dhe ndoshta thelbi është ky: Filmi hapet me Bernsteinin e moshuar, shumë vjet pas vdekjes së Felicias, duke u intervistuar për televizion dhe kamerat duket se gjithmonë janë mbi të – gjatë gjithë filmit. Ky është, në fund të fundit, dirigjenti që arriti famën stratosferike, pjesërisht falë imazhit të tij publik dhe mënyrës se si e përdori mediumin televiziv për të zgjeruar interesimin për muzikës klasike – për shikuesit e rinj dhe amerikanët mesatarë. Filmi

sugjeron, qëllimisht ose jo, se performanca nuk mbaroi kurrë për Bernsteinin, se ai gjithmonë e luante një rol.

Maestro disi vërteton se Cooperi është regjisor me vizion të vërtetë, edhe pse ky nuk është film veçanërisht i suksesshëm. Me gjakftohtësi epike e rikrijon telefonatën legjendare të 14 nëntorit 1943, kur Bernsteinit të ri, atëherë asistent-dirigjent në Filarmoninë e Nju-Jorkut, në minutën e fundit iu kërkua ta zëvendësonte mysafirin Bruno Walter që ishte me grip, për të ekzekutuar një koncert në Skenën Karnegi – koncert ky që do të transmetohej drejtpërdrejt në radio. Perdja masive dhe drita që filtrohet rreth skajeve të saj dominon ekranin, teksa Lenny merr telefonatën që do të ndryshojë jetën e tij dhe rrjedhën e muzikës klasike në Shtetet e Bashkuara. Kur triumfalisht e hap perden për ta lënë shpërthimin e dritës për t’u futur në dhomë, e shohim se është në shtrat pranë një burri, David Oppenheimit (Matt Bomer) i cili për disa vjet ishte i dashuri i Bernsteinit – përpara se ta takonte Felician. Më pas, kamera e ndjek Bernsteinin;

skena hapet në orkestër, në një pamje delirante që ngjall natyrën marramendëse të ngritjes së tij të papritur në një personazh të famshëm.

Maestro nuk është filmi veçanërisht i gjatë apo i dendur. Thuhet se Cooperi është shprehur për të si “biopik”, dhe nuk është e vështirë të kuptohet pse. Filmi nuk pretendon të jetë vështrim i plotë për Bernsteinin, dhe ka shumë aspekte të jetës dhe karrierës së tij që nuk përmenden. Fokusi këtu është në martesën e tij me Felician, te homoseksualiteti dhe te dirigjimi i tij – të gjitha këto të ndërthurura në mënyrë emocionale. Felicia duket se e kupton Lennyn, më mirë sesa ai e kupton veten. (“E di saktësisht se kush je”, thotë ajo më herët. “Le ta provojmë.”) Ai ashiqare e do dhe ka një kimi të mirë mes Cooperit dhe Mulliganit. Megjithatë, në dirigjimet e tij – në ato shfaqje të tërbuara, shpërthyes publike që Cooperi përsëri i rikrijon për mrekulli – ndiejmë një shqetësim të brendshëm, një njeri që për ta gjetur veten dëshiron të dalë nga lëkura dhe nga karakteri i vet.

Kjo është një ide e bukur, prekëse,

por filmi ndihet sikur ngec në aspektin emocional, ndoshta sepse ky ndërtim bazohet në idenë e mohimit. Është gjithashtu ndoshta arsyeja se pse Mulligani gati se e mënjanon Cooperin nga ekрани: Felicia e tij duket se saktësisht e di se kush është dhe zemra jonë thyhet për të, ndërsa Lenny është dinamo e shqetësuar, i pamundur për t’u identifikuar, një njeri që nuk kurrë u vetaktualizua. Ka një moment të mrekullueshëm afër fundit, në të cilin Bernstein, tashmë plak, kërcen me studentët e tij gjatë një feste në Tengëlvud, dhe ne e mbërthejmë një vështrim të shkurtër të lirisë së pambrojtur. Por, mbetet një si paraqitje e shkurtër. Në këtë kuptim, mbase filmi është në përputhje me linjat e tij hapëse, diçka që Bernstein i vërtetë e tha: “Vepra e artit nuk u jep pyetjeve përgjigje, por i provokon ato; dhe kuptimi thelbësor i tij është në tensionin midis përgjigjeve kontradiktore”. Nëse Maestro të zhgënjën nga mungesa e zgjidhjes, ndoshta kjo është për shkak se kështu duhet të jetë. /Telegrafi/

Promovohen botimet 'Rea' dhe librat e parë të kësaj shtëpie botuese



Mbrëmë në KultPlus Caffe Gallery u promovuan pesë libra të rinj të Botimeve REA, ku morën pjesë personalitete të jetës akademike dhe kulturore si profesorë, shkrimtarë, gazetarë, studentë e dashamirë të shumtë të librit.

Me këtë rast u promovuan librat: "Mahnitja e parë" (Demë Topalli), "Lexuesit e kartëmortaleve" (Binak Kelmendi), "Mëkati i buzëqeshjes" (Sali Bashota), "Misioni i Shkrimtarit" ese të nobelistit Elias Canetti (përkthyer nga Naim Kryeziu) dhe "Sytë flasin në heshtje" (Afërdita Bashota-Podvorica).

Aktivitetin e moderoi Rozafa Bashota, ku fillimisht falënderoi drejtoreshën e KultPlus Znj. Ardiana Pajaziti dhe të gjithë pjesëmarrësit e pranishëm. Rozafa, ndër të tjera, foli për projektet kryesore të Botimeve REA: "Padyshim se qëllimi ynë është të botojmë libra që janë në interes të lexuesve, si ata nga fusha e psikologjisë, letërsisë, libra biografikë, si dhe ribotime të autorëve të njohur të Kosovës që gjeneratat e reja kanë pak ose fare informacion për to.

Unë vetë jam nga fusha e Psikologjisë dhe e them me bindje që librat psikologjikë dhe përkthimet nga gjuhët e huaja do të jenë një shtesë e padiskutueshme e Botimeve REA. Përveç se janë të rëndësishëm ta ngrisin kulturën e leximit në vendin tonë, janë po ashtu të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijesimit për çështje të ndryshme psikologjike, të cilat për fat të mirë po iu shërbejnë lexuesve në vendin tonë në gjetjen dhe njohjen e vetvetes.

Një nga prioritetet e kësaj shtëpie botuese do të jenë edhe aktivitetet e ndryshme që ndërliken me

arsimimin kulturor. Natyrisht bashkëpunimi me shkrimtarët dhe përkthyesit do të jetë një kaptinë me vete në realizimin e synimeve tona.

Do të përpiqemi që t'i ndjekim standartet më të reja në praktikën botuese me qëllim të afirmimit të së drejtës së autorit, në kthimin e dinjitetit të autorit, duke respektuar mundin e tyre krijues." Në vazhdim, Alketa Gashi, interpretoi poezitë: "Koha" dhe "Heshti" të Demë Topallit, tregimin "Te pllaka përkujtimore" të Binak Kelmendit, pjesë nga eseja "Misioni i Shkrimtarit" të nobelistit Elias Kaneti, prozën poetike "Rrëfimi për pëllumbat e bardhë" të Sali Bashotës dhe poezitë "Ju jeni si qielli si dielli si hëna" dhe "Vetëm unë e kam emrin tim" të Afërdita Bashota-Podvoricës. Ndërsa me kitarë e përcolli Lind Bobi.

Librat "Mahnitja e parë" e Demë Topallit dhe "Misioni i Shkrimtarit" ese të nobelistit Elias Canetti, janë përkrahur për botim nga Komuna e Prishtinës. Ndërsa, veprat "Lexuesit e kartëmortaleve" e Binak Kelmendit dhe "Mëkati i buzëqeshjes" e Sali Bashotës janë përkrahur nga Komuna e Fushë Kosovës.

Ky aktivitet promovues i Botimeve REA kishte një organizim të veçantë meqë secili nga autorët foli për krijimtarinë e vet letrare, e sidomos për librin që u promovua.

Fjala e autorit Demë Topalli:

Së pari, dua t'ju them që kisha dilema për botimin e këtij libri. Arsyeja është se kam botuar vetëm katër libra, "Vera e iku" "Druri i fatit, "Haber i mirë" dhe "Sytë që dinë me pa" dhe distanca kohore e

nuk jeton më. Shumë herë gjatë jetës m'u kanë kujtuar këto fjalë. Mirëpo, kurrë s'e kam besuar që ato, pas dhjetëra vjetësh, do të vijnë e do të shkrihen në një fjalë-figurë, me një tingëllim e domethënie tjetër.

Kisha shkruar poezinë me titullin "Kafaz", një poezi për vetminë e krijuesit, që fillonte me këto tri vargje: "Prej një zjarri të lashtë malli/ Dhe copëza të thërrmuara kujtimesh/ Një mjeshtër i heshtur të ka bërë"/. Fjala i heshtur këtu më dukej fort e zakonshme, gati e ligjërimin të pëditshëm. Kam persiatuar gjatë për zëvendësimin e kësaj fjale. Një ditë, derisa po mendoja rreth saj, m'u kujtuan fjalët e dikurshme iu ka nxan goja dhe ashtu vetvetishëm, aty për aty krijova nga këto fjalë fjalën-figurë, gojëzanë, që me kohë erdhi e u bë intime dhe e admirueshme për mua. E kam përdorur katër herë në kontekste të ndryshme në poezi.

Po e vazhdoj me poezinë "Koha". Megjithë preokupimin tim të gjatë për të shkruar një poezi për kohën, poezia "Koha" vjen si fryt i leximeve. Megjithatë, ajo literaturë e paktë që kisha lexuar për kohën, më dukej abstrakte, tepër spekuluese, askund nuk e gjeta atë që do të më nxiste ta shkruaja këtë poezi, kështu që me kohë hoqa dorë nga kjo ide. Mirëpo pas dhjetë vjetësh, derisa po lexoja librin "Habia filozofike" të autores Zhanë Hersh, aty ku flitej për kohën, autorja thotë se askush s'është marrë më intensivisht me kohën sesa Shën Agustini, por edhe që ka thënë se po të më pyesni konkretisht, unë ç'është koha nuk e di. Falë këtyre fjalëve unë e shkrova poezinë "Koha". Po të mos e kisha lexuar librin "Habia filozofike", me siguri nuk do ta kisha shkruar kurrë poezinë "Koha".

Edhe poezia "Heshti" e ka zanafillën gjithashtu nga rinia ime e hershme. Derisa në bahçe, nën hijen e një molle po lexoja librin "Vjersha dhe poema" të Sergej Jeseninit, përkthyer nga Esad

Mekuli, si papritmas mu në fletët e librit ra një gjeth i thatë. S'ishte koha kur bie dushku, siç themi ne, ndaj më shkuan sytë te një degë e thatë e mollës. Dega e thatë, gjethi i thatë, i rënë në fletët e librit, qetësia absolute, krijuan tek unë disi habi, një atmosferë prekëse, medituese. Ky kujtim më ka shoqëruar pothuajse tërë jetën dhe falë tij, te poezia me titullin "Heshti", e cila flet për hapësirat e fshehta e të ndritshme të krijuesit, janë krijuar vargjet "Heshti" një hapësirë/Hapësirë prej një flakërimi të lashtë/Ku një lule çel edhe në degën e thatë/. Pothuajse pas pesëdhjetë vjetësh, në një moshë tjetër, kur njeriu preokupohet më shumë rreth të kaluarës, fëmijërisë, kalueshmërisë së jetës dhe vdekjes, falë atij përjetimi, falë asaj dege të thatë e atij gjethi të thatë, unë shkrova poezinë me titullin "Heshti", që aq shumë e kam për zemër.

Dhe në fund, jam shumë i kënaqur që libri im është libri i parë i botuar nga shtëpia e re dhe serioze botuese "Rea", e drejtuar nga Rozafa Bashota.

Fjala e autorit Binak Kelmendi:

Promovimi i një libri mbetet gjatë në mendjen e autorit të tij dhe besoj se mbetet gjatë edhe në mendjen e botuesit. Aq më shumë dhe sidomos mbetet gjatë në mendjen e një botueseje të re e plot dhunti, iniciativë dhe ambicie siç është në këtë rast Rozafa Bashota. E përgëzoj.

Tani disa fjalë për përmbledhjen time me tregime "Lexuesit e kartëmortaleve".

Libri përmban 17 tregime nga gjithsej 55 tregimet e mia, botuar deri më tash në tri përmbledhje tregimesh. Vetëm tregimi "Lexuesit e kartëmortaleve", nga i cili bart emrin përmbledhja, është tregim i ri që më duket se, siç themi ne nganjëherë, ka fjetur vetëm një vit për ta parë dritën dhe për t'u



bashkuar me tregimet tjera që janë botuar edhe para më shumë se tridhjetë vjetësh.

Gjatë hartimit të librit, dilema e parë dhe e gjithëhershme e autorit mbetet ajo: A thua në këtë përmbledhje a po përfshihen tregimet më të mirë. Tregimet më të mirë, sipas autorit të tyre, sepse vlerësimi "më i mirë" është çështje e shijes individuale dhe atë nuk ka të drejtë ta nënvlerësojë askush. Dhe siç thashë, dilema më ka mbetur edhe tash, pas botimit të këtij libri. Për shkak se gjithnjë mendoj se ka mundur të jetë edhe ky ose ai tregim. Kjo dilemë mund të hiqet, ndoshta, me botimin e një përmbledhjeje tjetër të re me tregime të zgjedhura.

Sido që të jetë, tregimet e përfshira në këtë libër janë tregime që përfshijnë periudhat tona kombëtare, madje që nga paraepoka siç është tregimi "Tërheqja zvarrë e Gentit nëpër Romë", por edhe periudhat më të hershme e më të vonshme që i kaluam e disa edhe i përjetuam. Siç ishin për shembull demonstratat e vitit 1968 e 1981 që janë tematikë e tregimeve "Te pllaka përkujtimore" dhe "Shqetësim nate i qytetit".

tona që na janë ngulitur sidomos pas çlirimit dhe këtu shembull do ta merrja tregimin "Arritja e Skenderbeut në Prishtinë", shkruar më 28 nëntor 2001.

Për botimin e librit meritë të madhe ka Profesor Sali Bashota i cila ka bërë redaktimin dhe pasthënien e tij. E falënderoj.

Fjala e përkthyesit Naim Kryeziu:

Kur flasim për Elias Kanetin atëherë kemi të bëjmë dhe flasim për një shkrimtar që ka rrënjët në Ballkan, për një shkrimtar vërtet të madh evropian, për një shkrimtar të përmasave botërore, pra, flasim për një nobelist.

Pse i themi këto fjalë të mëdha për këtë shkrimtar të madh, i themi sepse Kaneti ka kulturë ballkanike, evropiane dhe botërore. Kaneti lindi jo larg Kosovës, ai lindi në Bullgari, ku edhe kaloi një pjesë të fëmijërisë së vet, në vitin 1911 prindërit e tij shkuan, bashkë me tre fëmijët e tyre në Angli. Pas vdekjes së parakohëshme të babait të Kanetit, familja shpërngulet



masat e njerëzve.

Elias Kaneti, të cilin kritika letrare e ka quajtur si një „klasik të gjallë“ dhe si një prej humanistëve më të mëdhenj të shekullit të njëzetë, më 1981 iu dha Çmimi Nobel për letërsinë.

Në përmbledhjen e eseve me titull „Misioni i shkrimtarit“, Kaneti analizon dhe trajton veprat e shkrimtarëve dhe të filozofëve të kulturave të ndryshme, ku pastaj në eset veta lexuesit i ofron ajkën e krijimtarisë letrare dhe filozofike të shkrimtarëve dhe filozofëve siç janë: Tolstoji, Byhneri, Kafka, Brehti, Krauzi, Hitleri sipas Shperit, Konfuci, Ditari i dr. Haçijës nga Hiroshima, etj.

Si veçanti më specifike e krijimtarisë letrare dhe filozofike e Elias Kanetit mund të veçojmë: "Pushteti dhe mbijetesa", "Roli i masës në shoqëri e në pushtet", "Lufta për pushtet", "Antropologjia e tij që nxorri vullnetin për pushtet e që e shtyen njeriun të vrasë nga dëshira për të mbijetuar", "Rëndësinë dhe përgjegjësinë e fjalës së shkrimtarit", "Urrejtja e Kanetit ndaj vdekjes", ku në lidhje me këtë çështje po japim edhe një citat të tij: "Edhe e bukura s'është e bukur, derisa ekziston vdekja".

Në eset e tij kushtuar misionit të shkrimtarit, Kaneti thekson qartë se nuk mund të quhet shkrimtar askush që nuk beson seriozisht në të drejtën e vet për të qenë i tillë. Shkrimtari që nuk arrin ta shohë gjendjen e botës ku jetojmë, zor se mund të thotë ndonjë gjë rreth saj. Dëshira dhe mesazhi e Kanetit është që shkrimtarët me misionin e tyre, me veprat e tyre të

formësojnë realitetin shoqëror dhe të luftojnë të keqën dhe të ndihmojnë të mirën për njerëzimin.

Prandaj detyra e përkthyesit do duhej të ishte të përkthej autorë dhe vepra me vlera artistike, ndërsa detyra e shtëpive botuese do duhej të ishte botimi dhe publikimi i këtyre veprave që kanë vlera dhe janë në interes të përgjithshëm për njerëzimin.

Për botimin e këtyre veprave felënderojmë përzemërsisht Shtëpinë botuese „REA“ dhe i urojmë shumë sukses!

Fjala e autorit Sali Bashota:

Cilat fjalë t'i zgjedh sonte?

Duke filluar nga vepra e tretë, "Plagomë" (1994) në secilën vepër time me poezi është i pranishëm nga një cikël me proza poetike, derisa e botova veprën e parë me proza poetike "Ëndrra në parajsë" (2006), pastaj veprat e tjera me radhë, siç janë: "Sytë e vetmisë" (2010), "Rruzullimi i zjarrit" (2011), "Zemërimi i heshtjes" (2014), "Shkallët e natës" (2020) dhe "Mekati i buzëqeshjes" (2023).

Në një intervistë timen në revistën "Akademia", që e bëri Berat Armagedoni, ndër të tjera, kam thënë se përmes prozës poetike synoj për të shenjuar një cak tjetër, diçka midis poezisë dhe prozës. Atë që nuk e kam thënë në librat e mi me poezi, jam përpjekur ta artikuloj në prozën poetike. Jo rrallë më duket vetja se jam midis dy lumenjve, për të provuar se në cilin lumë do të notoj më shumë, por edhe më mirë. Fundja, nuk

mund të bëj krahasime, prandaj poezia dhe proza poetike, pothuajse, janë i njëjti kërkim imi, i paraqitur në variante të ndryshme, ngjitur nëpër shkallët e imagjinatës, por edhe nëpër shkallët e jetës.

A mund të ketë proza poetike mesazh, kuptim dhe domethënie tjetër?

Ky është një lloj preokupim krijues që më ka nxitur ta kuptoj përbrenda vetes një teori të komunikimit, por edhe një teori të receptimit për të, duke provuar "një zgjatje të kujtesës", siç do të thoshte Borhesi, edhe për ligjërimin, ritmin dhe figurat. Nga cilët faktorë do të përcaktohej gjuha metaforike (poezia) që të bëhej gjuhë e rëfimit (proza). Në fakt, parimet krijuese besoj se shkojnë në të njëjtin drejtim, me një ndryshim të vogël që proza poetike mund ta funksionalizojë fabulën. Me prozën poetike jam përpjekur të rrëfej ngjarje dhe të përshkruaj situata.

Pse vepra "Mekati i buzëqeshjes", erdhi në vjeshtën e vitit 2023, pikërisht përmes Botimeve "Rea". Pagëzimi i shtëpisë botuese me emrin e vajzës sime të gjashtë Rea, e mban të mbërthyer në shpirtit tim, pothuajse, të njëjtën ndjenjë sipërore, sikurse kur e pagëzova Shtëpinë Botuese "Rozafa", në vitin 1997. Asnjë mëdyshje. Vajza ime Rozafa, tash si botuese do të udhëtojë nëpër kohën e rigjetur, për ta kuptuar edhe më fuqishëm se çka është bota e librit. Tash është një tjetër kohë e imagjinatës që shfaqet në realitetin jetësor përmes veprës dhe që bëhet e pavdekshme.



Natyrisht, letrarisht është përfshirë edhe lufta e vitit 1998-1999 dhe tregimet "101 vjet bashkë" dhe "Fëmija pa emër" tregojnë për kalvarin tonë të fundit. Ndërsa për luftën po tregoj se ajo trajtohet në tri romanet e mia "Vezët e Vdekjes", "Guri i Vashës" dhe "Portat e Pejës".

Në këtë përmbledhje ka edhe tregime që kujtojnë jetën familjare që nuk ka si të jetë ndryshe nag jeta e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. "Autopsia e natës" dhe "Babai do t'ia falte arën Ushtrisë Amerikane" e ndonjë tjetër.

Ka edhe tregime të tjera që pasqyrojnë, sipas meje, inatet

përkohësisht në Lozanë të Zvicrës, kurse më 1913, përfundimisht shpërngulën në Vjenë e më pas në Cyrih të Zvicrës.

Me krijimtarinë e vet letrare dhe eseistike e sidomos me romanet "Vërbimi", "Loja e syve", "Gjuha e shpëtuar", "Pishtari në veshin tim", "Masa dhe pushteti" si edhe "Vetëdija e fjalëve", Kaneti u bë botërisht i famshëm dhe mbeti në mendjet e lexuesit gjithandej. Në veprën e tij madhështore "Masa dhe pushteti", në të cilën Kaneti punoi gati 34 vjet, ai analizon dhe përshkruan shprangosjen e njerëzve në masa dhe dominimin e sundimtarëve sociopatikë mbi



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova U18 përfundon turneun në Belgjikë

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Me ndeshjen e së premtes ndaj Polonisë, Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll (meshkujt) ka përkundur turneun në Lokeren të Belgjikës. Pjesëmarrja në

turneun "4 Nations Handball Trophy" është shumë e rëndësishme për zhvillimin e kësaj gjenerate. Kjo ishte përvoja e parë ndërkombëtare e kësaj grupmoshe,

"dardanët" e rinj tanë kanë kuptuar se për të konkurruar në nivel evropian u duhet punë shumë më e madhe dhe sistematike. Ndaj Polonisë, Kosova vetëm në çaste ka shfaqur gjëra pozitive. Në

fund rezultati ishte 38:19 për polakët. Kohë për të pushuar për Përfaqësuesen U18 nuk do të ketë. Që në fillim të janarit Kosova U18 luan në Shkup kualifikimet për Evropian.



Sfidat e Superligës fillojnë me një minutë heshtje për Ilmen Bajrën

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Fundjava dhuron sfida interesante në Prince Caffè Superligën e Kosovës, ku zhvillohet xhironja e 14-t. Për shkak të ndarjes nga jeta të trajnerit të basketbollit, Ilmen Bajra, të gjitha ndeshjet e kategorive seniore dhe të reja do të fillojnë me një minutë heshtje. Bajra ka qenë ndihmëstrajner i Kosovës A, përzgjedhës i Kosovës U18 Femrat, trajner i Bashkimit të meshkujt dhe femrat, ndihmëstrajner në Prizreni 16, Sigal Prishtinë dhe Rahovec, kurse së fundi ishte trajner i skuadrës gjermane të femrave Bad Homburg Falcons. Vdekja e tij e hershme tronditi komunitetin e basketbollit, që do ta përkujtojë gjithmonë. Takimi i parë i kësaj jave është ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Trepçës. Të dyja skuadrat luajnë për fitore dhe pritet një sfidë interesante. Therandasi kanë tetë fitore e pesë humbje, kurse mitrovicasit 11 fitore e dy humbje, duke e bërë përballjen kryesore të kësaj xhironje. Të shtunën do të ndeshen dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës, Bashkimi dhe Peja. Prizrenasit kanë katër

fitore e nëntë humbje, derisa pejanët nëntë fitore dhe katër humbje, andaj luajnë për fitore në këtë takim mjaft interesant. Të dielën po në Prizren do të takohen Istogu dhe Proton Cable Prizreni. Istogasi janë në vendin e fundit me një fitore dhe 12 humbje, ndërsa skuadra prizrenase ka katër fitore dhe nëntë humbje. Të dyja skuadrat synojnë fitoren për synimet që kanë për këtë edicion. Java e 14-t mbyllet me sfidën në mes të Sigal Prishtinës dhe Vëllaznimit. "Bardhekaltrit" numërojnë tetë fitore e pesë humbje, kurse kuqezinjtë shtatë fitore e gjashtë humbje, andaj pritet një sfidë interesante në kryeqytet.

SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
17:00 Ylli - Trepça
19:00 Bashkimi - Peja

Të dielën takohen:
17:00 Istogu - Prizreni
19:00 Prishtina - Vëllaznimi



Ismajli: Kualifikimi në Evropian, ëndërr e bërë realitet



EMPOLI, 22 DHJETOR - 2023 ishte një vit fantastik për qendërmbrojtësin kuqezi Ardan Ismajlin i cili është kthyer në një pikë referimi tek Empoli, një titullar i padiskutueshëm, i paprekshëm edhe në sytë e trajnerit të Kombëtares së Shqipërisë. Ndryshe nga pjesa më e madhe e legjionarëve kuqezi, për Ismajlin flitet pak në Serinë A, kur bëhet fjalë për merkato, pasi dëshira e tij është

të vijë tek Empoli, të zhvillojë aty një sezon pozitiv, pasi në verë është edhe "Euro2024". Në vigjilje të sfidës kundër Lazios, Ismajli zbuloi objektivat e tij: "Në këtë moment, gjëja më e rëndësishme për mua është të qëndroj në Serinë A dhe të arrij diçka historike për Empolin. Sigurisht, të shkoja në Evropian është një sukses i madh. Do të luaj për herë të parë në një Evropian, kjo ishte ëndrra ime e

madhe dhe tani është bërë realitet". Ismajli, duke u ndalur më pas te sfida me Lazion, ku përballë do ta ketë Ciro Immobilen, rival me të cilin do të përballet edhe në Evropian. "Kjo është Seria A, një nga kampionatet më të vështirë në botë dhe të gjithë sulmuesit janë të fortë. Ashtu siç kemi bërë deri më sot, do të bëjmë më të mirën për t'i ndalur sulmet e tyre", ka deklaruar Ismajli.

Hasani paraqitet te Rapidi i Bukureshtit

Bukuresht, 22 dhjetor - Sulmuesi Florent Hasani është paraqitur futbollist i Rapidit të Bukureshtit. Futbollisti nga Kosova i është bashkuar skuadrës rumune nga Tirana për 300 mijë euro. Raportohet se

Florent Hasani ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me Rapid Bukureshtin, derisa ka zgjedhur numrin 8 te skuadra nga kryeqyteti i Rumanisë. 26-vjeçari te Rapidi do të bashkohet me futbollistin tjetër nga Kosova,

Ermal Krasniqin, që u transferua nga Ballkani verën e këtij viti. Ndryshe, Hasani ka pasur një gjysmë sezoni fantastik me Tiranën duke shënuar 10 gola në 16 ndeshje, ndërsa sezonin e kaluar ai ishte golashënuesi më i

mirë në Kategorinë Superiore me 16 gola të shënuar. Në Kosovë ai kishte veshur fanellën e Vushtrrisë dhe Trepçës '89, ndërsa në Evropë karrierë ka bërë tek ekipet si Diosgyr, Kfar Saba dhe Gyirmot.



Khaka nuk di për humbje me Leverkusenin

Leverkusen, 22 dhjetor - Mesfushori shqiptar, Granit Xhaka, nuk ka shijuar ende humbjen që nga transferimi i tij në verë të Bayer Leverkuseni. Xhaka kompletoi kalimin e tij nga Arsenali te Leverkuseni për një shifër prej

15 milionë eurosh. Megjithatë, ndikimi i mesfushorit nga Kosova ka qenë shumë i madh te klubi i udhëhequr nga Xabi Alonso. Xhaka nuk di për humbje me klubin gjerman, pasi në 23 ndeshje në të gjitha garat deri tani, ai ka 20 fitore

dhe tri barazime. Leverkuseni ka mbyllur sezonin vjeshtor si lider në Bundesliga, duke mbledhur 42 pikë nga 16 ndeshje, ndërsa ka kaluar pa humbje grupin në Ligën e Evropës. Në Ligën e Evropës, Leverkuseni fitoi gjashtë

ndeshjet, duke pasur një golaverazh prej 19 golave të shënuara dhe vetëm tri të pranuar. Kjo formë e ekipit të Alonsos me Xhakën lider ka bërë që tifozët e "Farmaceutikëve" të ëndërrojnë për trofe.



Joshua i vetëdijsihëm se ka vetëm një mundësi: Nëse humbas, nuk kam të ardhme

LONDËR, 22 DHJETOR - Anthony Joshua pranon se "nuk ka të ardhme" nëse nuk arrin ta mundë Otto Wallin në "ditën e llogarisë", në mbrëmjen magjike të boksit që do të zhvillohet më 23 dhjetor në Arabinë Saudite. Dy herë kampioni i botës synon ta fitojë luftën e tij të tretë të vitit 2023, pasi tashmë ka fituar ndaj Jermaine Franklin Jr dhe Robert Helenius më herët. 34-vjeçari britanik e kupton se humbja mund të jetë e dëmshme për të ardhmen e tij në këtë sport. Ai tha në konferencën për shtyp: "Unë e di se ku po shkoj në jetën time, por duhet të them se kjo është një pikë kontrolli dhe nëse nuk e kaloj këtë, nuk ka të ardhme. Kështu që, jam



plotësisht i fokusuar në duelin ndaj Otto Wallin dhe duke bërë punën time". "Me zemrën, shpirtin dhe çdo qelizë në trupin tim të fokusuar te dueli ndaj Otto Wallin dhe duke ditur se çfarë mund të bëj. Synoj të bëj një duel të mirë. Jam këtu për të dubluar. Dua të performoj mirë dhe të bëj atë presion mbi veten time sepse dua të fitoj. Kam atë dëshirë për të fituar dhe dua ta lëndoj edhe kundërshtarin tim", ka thënë

Joshua. Boksieri suedez Wallin, 33 vjeç, ka vetëm një humbje në karrierën e tij, kur humbi ngushtë nga Tyson Fury më 2019. Që nga ajo kohë i ka fituar të gjashtë duelet e tij. Ai u zotua se do të fitojë të shtunën: "Është një sfidë dhe një mundësi e madhe. Kam punuar shumë për të qenë këtu dhe tani është koha për ta shijuar momentin, për ta fituar luftën dhe për të ecur përpara".

DUELET E 23 DHJETORIT:

Anthony Joshua - Otto Wallin
Deontay Wilder - Joseph Parker
Daniel Dubois - Jarrell Miller
Dmitrii Bivol - Lyndon Arthur
Arslanbek Makhmudov - Agit Kabayel
Jai Opetia - Ellis Zorro
Filip Hrgovic - Mark De Mori
Frank Sanchez - Junior Fa

Minnesota fluturon lakersat në perëndim, Milwaukee udhëheq në lindje



Minnesota, 22 dhjetor - Minnesota rikthehet te fitorja pas triumfit me rezultat 118-111 ndaj lakersave, duke forcuar pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje me rivalitet, ku për lakersat u dallua Davis me 31 pikë, por që s'mjaftuan. Të gjithë titullarët e Minnesotas realizuan

mbi 14 pikë (Edwardsi me 27 pikë më i miri). Humbet edhe skuadra tjetër e Los Anxhelosit, ajo e clippersave, që u mund me rezultat 134-115 nga Oklahoma, që ngjitet në vendin e dytë në perëndim. Alexander Shai me 31 pikë ishte lider në fushë për Oklahomën. Jashtë fushës fitoi skuadra e Utah

REZULTATET

Detroit - Utah Jazz	111-119
Cleveland - New Orleans	104-123
Chicago - San Antonio	114-95
Memphis - Indiana	116-103
Milwaukee - Orlando	118-114
Oklahoma - Clippers	134-115
Minnesota - Lakers	118-111
Portland - Washington	117-118

Jazzit, që falë 27 pikëve të Ulynyk, mposhti Detroitin (119-111). Në lindje komandon ekipi i Milwaukee, që triumfoi me rezultat 118-114 ndaj Orlandos, ndeshje ku u dallua Antetokounmpo me 37 pikë e 14 rebounde. Fitore të rëndësishme korri skuadra e Memphisit, që mposhti me rezultat 116-103 Indianan (mungoi Embiid). Më i miri në fushë për vendasit ishte Bane, autor i 31 pikëve.

SHKURT

Tri klube angleze në garë për Brojën

Armando Broja mund të ndryshojë skuadër në janar, duke parë vështirësitë e mëdha që po kalon me Chelsean këtë sezon. West Hami në ditët e fundit ka shtuar ndjeshëm interesimin për yllin e Shqipërisë. Fulhami është gjithashtu, shumë i interesuar për një sulmues tipik. Nuk përjashtohet as mundësia e një transferimi te Newcastle, që shihet si një zgjedhje ideale për momentin. Afrimi i Brojës mund ta shtojë konkurrencën, në një sezon të gjatë që do të jetë i mbushur me ndeshje.

Federeri: Sot tenistët mendojnë më shumë për 'numrin 1' sesa për t'i argëtuar fansat

I tërhequr prej më shumë se një viti nga sporti, tenisti zviceran Roger Federer ka folur për atë që po ndodh sot në këtë sport. Beteja për atë se cili është tenisti më i mirë, ai u shpreh: "Sot jetojmë në një botë të bazuar te numrat dhe statistikat".

"Të gjithëve u pëlqejnë t'i përmirësojnë statistikatat e tyre dhe t'i mposhtin rekordet e të tjerëve. Kjo ndoshta është mënyra për të vendosur edhe se cili është më i miri. Sapo fiton një grand slam bëhesh numri 1 dhe të gjithë pyesin për sa kohë do të qëndrosh në majë apo kur do ta fitosh turneun tjetër", ka thënë Federer. "Për fat të keq, sot argëtimi ka kaluar në plan të dytë dhe kjo është e trishtë. Ky mekanizëm për të qenë numri 1 është ushqyer aq shumë sa është kthyer në një problem. Të paktën kështu mendoj unë", u shpreh Federeri. Gjatë karrierës së tij të jashtëzakonshme, zvicerani ka fituar 20 grand slame dhe 103 turne në total (28 turne Masters, 6 ATP Finales).

Arsenali refuzon Superligën evropiane

Arsenali është klubi i radhës i madh evropian që e ka refuzuar krijimin e Superligës evropiane. Përmes një njoftimi ata u shprehën se pozicioni i tyre në lidhje me Superligën evropiane nuk ka ndryshuar. "Pozicioni ynë në lidhje me Superligën evropiane nuk ka ndryshuar. Ne do të vazhdojmë të luajmë në garat e UEFA-s dhe do të vazhdojmë të punojmë me klubet e tjera evropiane dhe me Shoqatën Evropiane të Klubeve (ECA)", thuhej në njoftimin e "Topçinjtë". Deri më tani, Barcelona, Real Madridi janë për dhe pritet që edhe Napoli ta pranojë këtë garë të re.

Ancelotti për Superligën: Vendim i rëndësishëm, s'duhet të ketë monopol

Carlo Ancelotti, trajner i Realit të Madridit, është pyetur pas fitores ndaj Alavésit për vendimin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në lidhje me Superligën. "Ishte një vendim i rëndësishëm për të gjitha klubet. Ka disa që nuk janë aq të bindur. Mendoj se do të jetë pozitive për të gjithë që të mos ketë monopol dhe të përmirësohet kalendari. Koha do të tregojë nëse është pozitive, por besoj se në fund do të jetë mirë për të gjithë botën", ka theksuar trajneri italian në konferencë për shtypin. Reali fitoi 1-0 në transfertë me Alaves, me golin e fitores që u shënua në kohën shtesë. "Los Blancos" luajtën me 10 lojtarë që nga minuta e 54-t, pas ndëshkimit të Nachos me karton të kuq.

Suarezi, afër ribashkimit me Messin

Gjigantët amerikanë të Inter Miamit planifikojnë të sjellin në Majemi edhe një tjetër ish-lojtar të Barcelonës. Bëhet fjalë për

"bomberin" uruguaiian, Luis Suarez, me negociatën të cilat kanë nisur prej disa javësh dhe tashmë është arritur çdo detaj, teksa e

vetmja gjë që kambetur është firma e kontratës, e cila do të jetë fillimisht njëvjeçare, me opsion rinovimi për një vit ekstra, nëse gjithçka shkon si

duhet në MLS. Sipas raportimeve të fundit të gazetarit Fabrizio Romano, Suarez pritet të fluturojë ditët në vijim drejt Miamit për t'i

finalizuar detajet përfundimtare të kontratës në dhjetor, pas përfundimit të kontratës me brazilianët e Gremios.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Mecis” SH.P.K. me seli në Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811976432 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavajte se svi klienti da drustvo sa “Mecis” D.O.O. Obiliq, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811976432 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Mecis” L.L.C. with headquarters Obiliq, has come to the decision to quit its business: 811976432 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Jani Beton” Sh.p.k – Fshati i Vjetër, Ferizaj në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Bazën e Prodhimit të Betonit, Fshati i Vjetër - Ferizaj

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.02.2024 në ora 11:00 në SHFMU “Muharrem Shemsedini” Fshati Bibaj, Komuna e Ferizajt. do të organizohet Debat Publik nga Kompania “Jani Beton” Sh.p.k – Fshati i Vjetër, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Jani Beton” Sh.p.k – Fshati i Vjetër, Ferizaj, për Bazën e Prodhimit të Betonit, Fshati i Vjetër – Ferizaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Feride Maxhuni, shpall te pavlefshme 3 dëftesat e shkollës se mesme “Xheladin Deda”.

- Jahir Hodaj, shpall te pavlefshme dëftesa e klasës 6,7,8 shkolla fillore “Migjeni”, Mitrovicë.

- Jahir Hodaj, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore klasa 1,2,3,4,5 -shkolla “Bajram Curri” Prizren.

- Razita Kajtazi, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Xheladin Deda”.

- Sadik Sahiti, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Harun Beka”.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishte na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishte na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

